

# Kronikë nga seanca 13-të

**Shkup, 05.03.2020** – Në seancën e sotme Këshilli i Agjencisë miratoi tre Vendime për ndalimin e procedurave të inicuar për heqjen e licencave për transmetim televiziv ndaj: TRD AMAZON SHPKPV Shkup, TRD Shutell SHPKPV Shkup dhe TRD KAPITOLL FM SHPKPV Shkup.

Për mosplotësimin e detyrimeve nga neni 80 paragrafi 5 nga Ligji për shërbime mediatike audio dhe audiovizuale, pra tarifë e papaguar vjetore për licencë për radio transmetim brenda afatit të përcaktuar ligjor, Këshilli i Agjencisë miratoi Vendim për heqjen e licencës për radio transmetim televiziv ndaj TRD Zoran Zdravković MX-RADIO Ohër SHPKPV.

Këshilli i Agjencisë gjithashtu miratoi dhe dy Vendime për fshirje nga regjistri i transmetuesit për TRD Radio BRAVO SHPKPV Kumanovë dhe TRD RTV DRINI SHPKPV Strugë.

Për të inicuar një procedurë që është në përputhje me Planin Vjetor të prokurimit publik për 2020 të Agjencisë, Këshilli dha miratim drejtorit të Agjencisë për të kryer procedurën prokurim publik-mallra: rrymë elektrike.